



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Kryetari

Nr. 4097/Prot.
13

Tiranë, më 27.01.2026

URDHËR

Nr. 8, datë 27.1.2026

**PËR
PËR SHTYRJEN E MBLEDHJES TË KËSHILLIT PËR RREGULLOREN, MANDATET
DHE IMUNITETIN**

Në mbështetje të nenit 73 të Kushtetutës, nenit 13, pika 5, dhe nenit 118 të Rregullores së Kuvendit, si dhe duke marrë në konsideratë se në mbledhjen e parë të Këshillit, të zhvilluar më datë 19.12.2025, deputetë anëtarë të këtij këshilli kanë kërkuar që shqyrtimi i kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar “ Për dhënie e autorizimit nga Kuvendi për arrestimin/heqjen e lirise së deputetit/ministrit/zëvendëskryeministrit nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit”, të lidhet me marrjen dhe vlerësimin paraprak të vendimit përkatës të Gjykatës Kushtetuese, duke vlerësuar se një shqyrtim i tillë synon garantimin e një procesi vendimmarrës të plotë, objektiv dhe në përputhje me parimet kushtetuese, me qëllim shmangien e cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe garantimin e rregullsisë kushtetuese të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së Kuvendit,

URDHËROJ:

- I. Shtyrjen e mbledhjes së Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin të parashikuar për datën 28.1.2026 ora 12.
- II. Mbledhja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin do të thirret dhe do të njoftohet në një datë tjetër.
- III. Ngarkohen shërbimet e Kuvendit për shpërndarjen me anë të postës elektronike zyrtare të urdhrit.
- IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


KRYETAR
Niko PELESHI
